




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE



Nr. i Protokollit: 02/ 567

**Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Petrovë**

E martë, më 20 qershor 2023

Kohëzgjatja e takimit: 17:40 –18:30

Vendi i takimit: SHMFU “Bajram Curri”

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini dhe Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani.

Rendi i ditës:

**1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026**

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, i cili i ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar që kanë gjetur kohë që sot të jenë së bashku me ne në këtë dëgjim publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

Më tutje z.Ademi tha se sot së bashku me ju do ta hartojmë buxhetin e Komunës së Shtimes për vitin 2024. Ai po ashtu e cekti se në vitin paraprak dëgjimet publike i kemi përmbledhur në një vend tre fshatra dhe e kemi parë që kjo gjë nuk ka qenë shumë efektive, prandaj këtë vit kemi vendosur që në secilin fshat të kemi nga një dëgjim publik, edhe pse orari për ne është më i gjatë këtë e kemi bërë për të mirë të qytetarëve të Komunës sonë.

Kryesuesi më tutje elaboroi buxhetin e këtij viti duke treguar që për vitin e ardhshëm do të ketë rritje të buxhetit të Komunës së Shtimes dhe kjo rritje do të shkojë direkt tek qytetarët në investime kapitale. Prandaj, sot jemi këtu që t'i marrim kërkesat e banorëve të fshatit Petrovë dhe së bashku t'i vendosim në buxhetin e vitit 2024, ju duhet të na tregoni prioritetet e juaja dhe një gjë tjetër të cilën duhet ta dini është që në investimet kapitale bëjnë pjesë kanalizimi, ndriqimi, trotualet dhe asfaltimi i rrugëve.

Më tutje z.Ademi i luti të gjithë të pranishmit që të merrnin fjalën dhe secili nga ta t'i ngriste kërkesat për fshatin Petrovë.

Kërkesat e banorëve të fshatit Petrovë:


- **Petrit Rexhaj:** Të bëhet rregullimi i prockës e cila po sjell mjaft shumë problemeve në rrugët e lagjeve, shpesh herë edhe duke u futur në oborret e shtëpive. Kjo prockë përfshin gjithsejt tre lagje të fshatit, duke përfshirë rrugën "Xhemshir Xhemshiri" dhe rrugën "Lumi". Të bëhet një shëtitore nga fusha e futbollit tek Kodra e Mullinit.
- **Gani Ademaj:** Të rregullohet kanalizimi.
- **Bafti Hysenaj:** Të vazhdohet trotuari që lidhet me lagjen "Rexhaj" dhe të rregullohet ndriqimi në të njëjtën rrugë, po ashtu të rregullohet kanalizimi në rrugën "Mehdi Korrani". Problem tjetër për fshatin Petrovë është edhe lëvizja e shpeshtë e kamionëve.
- **Ramadan Rashiti:** Të rregullohet kanalizimi në rrugën "Nazim Baku". Të bëhet rregullimi i prockës në lagjen "Rashiti", kërkesë tjetër është edhe rregullimi i shtratit të lumit në të dyja anët. Në pjesën e epërme të rrugës "Qamil Osmani", të rregullohet çeshmja dhe të bëhet një park i vogël në rrugën "Fadil Rashiti".
- **Argjend Hysenaj:** Të bëhet rregullimi i "rrugës së kuqe" ose ndryshe rruga "Haxhi Zeka", gjithashtu të bëhet dhe ndërtimi i çerdhes.
- **Baki Rashiti:** Te rruga "Qamil Osmani" dhe "Nazim Baku" a do të ketë ndriqim? A do të rregullohet ujësjellësi dhe çerdhja? Gjithashtu edhe një kërkesë tjetër, kanalizimi i cili është në fshatin Petrovë të kontrollohet nga inspektorët e fushës.
- **Asllan Beqaj:** Të rregullohet kanalizimi në fshatin Petrovë nga rruga "Xhemshir Xhemshiri" deri tek lagjia "Hysenaj".

Procesmbajtës  
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME



Lista e pjesëmarrësve

Petrovë

Data: 20.06.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1	Amir Ademaj	
2	Bahri Rexha	
3	Petar Rexha	
4	ARGJEND HUSENAT	
5	ELMI ADEMAJ	
6	Jonidan Foridaj	
7	Asllan Beqaj	
8	Besnik Selan	
9	Armin Ademaj	
10	Negjmedin Bajraj	
11	Jakob Zymeraj	
12	BAFTI HUSENAT	
13	Baki Roshtaj	
14	Rajf Robitaj	
15		
16		